

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.74 /2025	Data: 30.04.2025	

Kuvendi i Komunës së Istogut, në pajtim me nenin 40 paragrafi 40.2 pika a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008) dhe nenit 33.1 pika 1) të Statutit të Komunës, 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2025 shqyrtoj dhe miratoj Rregulloren për Transparencë Komunale dhe mori këtë :

V E N D I M RREGULLORE PËR TRANSPARENCË KOMUNALE

1. Miratohet Rregullorja për Transparencë Komunale.
2. Rregullorja për Transparencë Komunale është pjesë përbërse e këtij vendimi.
3. Inkurajohen dhe ftohen të gjithë qytetarët, personat juridik dhe shoqatat civile në territorin e Komunës së Istogut, që t'i parashtrojnë vërejtjet dhe propozimet e tyre në këtë Rregullore brenda kohës dhe afatit të përcaktuar në pikën 2. të këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqe të Komunës dhe për zbatimin e tij është përgjegjës : Kryetari i Komunës.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtoria për Administratë, Zyra Ligjore dhe një kopje në arkivin e Kuvendit të Komunës së Istogut.

 REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL DREJTORIA PËR ADMINISTRATË - DIREKCIJA OPRAVE		
II		
Nr./Br.	039-55	Nr. i faq./Br. 01
Data/Datum	07 / 05 / 2025	
19756 • 103-K		

Kryesuesi i Kuvendit

z. Enver Rugova

ERugova



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.73/2025	Data: 30.04.2025	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 dhe 40 paragrafi 40.2 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) dhe nenit 33.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01Nr.62/10, nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, Ligjin nr. 08/L-332 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në mbledhjen e mbajtur me dt: 30.04.2025, shqyrtoi dhe miratoi propozimit e Kryetarit të Komunës për Bartjen e mjeteve të pashpenzuara buxhetore të të hyrave nga viti fiskal 2024 në vitin 2025 dhe mori këtë:

V E N D I M

Aprovohet propozimi i drejtorisë për Buxhet dhe Financa për bartjen e mjeteve të pashpenzuara buxhetore të të hyrave të bartura nga viti fiskal 2024 në shumën prej : 215,695.76 €, dhe të hyrat e tejkaluara në shumën prej: 734,656.74 € , total shuma për bartje është 950,352.50 €, sipas tabelës për shpërndarjen në këto kategori ekonomike si në vijim:

I. Fondi burimor 22, shuma prej 215,695.76 €, të bartet si në vijim:

1. Kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime: 22,596.05 €

Infrastruktura Rrugore (18017):

Arsyetim : Shtim i buxhetit për këtë kontratë ekzistuese për sanim të gjendjes nga fatkeqësitë natyrore

7,596.05 €

Bujqësia (47017) :

Arsyetim : Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit me Ndërmarrjen "Drini i Bardhë", është planifikuar realizimi i aktiviteteve të përbashkëta për mirëmbajtjen e të gjitha kanaleve të ujitjes në territorin e Komunës së Istogut.

15,000.00 €

2. Shpenzime Komunale:

966.53 €

Infrastruktura Rrugore (18017):

Arsyetim: Rritja e çmimit të energjisë elektrike vitin e kaluar ka ndikuar në rritjes e kategorisë së Komunalive, duke pasur për sysh kërkojmë që edhe në vitin 2025 të baret kjo shumë në të njëjtën kategorinë ekonomike.

966.53 €	
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK DREJTORIAT PËR ADMINISTRATË DREKCIJA UPRAVL	
Nr./Br. 039 - 59	Nr. i faq/Br.str 03
Data/Datum 07 / 05 / 2025	
ISTOG • ISTOK	

3. Subvencione dhe Transfere:

19,050.96 €

Zyra e Kryetarit (16017):

Arsyetim: Në bazë të planit vjetor të punës së Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së - Dega në Istog, dhe me qëllim të realizimit të aktiviteteve të parapara në agjendë, paraqitet nevoja për bartjen e mjeteve financiare që do të mbulojnë:

10,000.00 €

Shpenzimet e funksionimit të administratës;

Organizimet sipas agjendës së shoqatës.

Bujqësia (47017):

Arsyetim: Për të mbështetur zhvillimin e bujqësisë dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese të fermerëve, është e nevojshme shtimi i buxhetit për përkrahjen me sera dhe fidane.

9,050.96 €

4. Investimet Kapitale:

173,082.22€

Buxhet dhe Financa me kod 175, nën-programi Buxheti - Istog me kod 17517, projektet:

Projekti i ri (Renovimi i shtëpisë së kulturës në "Cerrcë")

Arsyetim: Si rrjedhojë, është identifikuar si e domosdoshme renovimi i objektit multi-funksional që do t'i shërbente komunitetit të gjerë për organizimin e ngjarjeve kulturore, trajnimeve, punëtorive dhe aktiviteteve të tjera sociale.

23,082.22 €

Projekti i ri (Ndërtimi i shtëpisë së komunitetit në "Shushicë të Ulët")

Arsyetim: Në fshatin Shushicë e Ulët mungon një hapësirë funksionale për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe komunitare, çka paraqet një pengesë për përfshirjen aktive të qytetarëve.

11,109.16 €

Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia me kod, 180 nën-programi Infrastruktura Rrugore - Istog me kod 18017,

Projekti i ri (Ndërtimi i objektit multifunksional në qendër të Istogut).

40,000.00 €

Arsyetim: Projekt i ri, me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe ofrimit më efikas të shërbimeve për qytetarët, është iniciuar një projekt i ri për sistemimin e Administratës së

Komunës së Istogut në objektin ekzistues të "Korenikut" në Qendër të Istogut.

(54976) (Ndërtimi i rrethojave të varrezave në Kërrninë lagja "Fekaj" dhe "Zeqiraj").

Arsyetim: Obligime kontraktuale nga viti 2024, projekti për ndërtimin e rrethojave të varrezave në lagjet "Fekaj" dhe "Zeqiraj" të fshatit Kërrninë është në kuadër të obligimeve kontraktuale të nënshkruara gjatë vitit 2024.

1,915.00 €

(53400) (Ndërtimi i kanalizimit në Lubozhdë "Shala e Kodrës").

Arsyetim: Projekti për ndërtimin e kanalizimit në zonën "Shala e Kodrës" në fshatin Lubozhdë është shtyrë për shkak të problemeve pronësore të evidentuara gjatë fazës së realizimit.

2,673.00 €

Projekti i ri (Ndërtimi i murit mbrojtës në Shushicë)

Arsyetim: Për shkak të rrezikut të rreshqitjes së dheut, e cila ka krijuar një kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë e banorëve në fshatin Shushicë e Epërme, është e domosdoshme ndërmarrja e një projekti emergjent për stabilizimin e terrenit dhe parandalimin e rreziqeve të mëtejshme.

10,000.00 €

(54969) (Ndërtimi i urave në: Vrellë, Gurrakoc, Dubravë, Padalishtë, Kërrninë, Kovragë, Kaliqan, Studenicë dhe Rakosh).

Arsyetim: Shtim buxheti përshkak të rritjes së dimensioneve të urave kërkohet buxhet shtesë në shumën e kërkuar.

8,000.00 €

Bujqësi, pylltari, zhvillim rural me kod, 470 nën-programi Bujqësia – Istog me kod 47017,

(53253) (Ndërtimi i kanalit të ujitjes "Jazi i Madh" në Istog të Poshtëm).

Arsyetim: Projekti për ndërtimin e kanalit të ujitjes "Jazi i Madh" në Istog të Poshtëm, i cili buron nga një obligim kontraktual i vitit 2023, ka pësuar vonesa për shkak të problemeve të evidentuara pronësore përgjatë trasesë së paraparë.

1,468.36 €

Projekti i ri (Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Lluga).

Arsyetim: Projekt i ri dhe emergjent marr parasysh që kanali kalon në mes të fshatit Lluga dhe paraqet probleme të vazhdueshme për banorët e këtij fshati të cilët janë të rrezikuar edhe nga vërshimet të cilat i shkakton ky kanal.

30,000.00 €

Zhvillim Ekonomik me kod 470, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik- Istog me kod 48017,

Projekti i ri (Ndërtimi i rrugës në Mojstir).

Arsyetim: Ndërtimi i rrugës në fshatin Mojstir është i nevojshëm si pasojë e dëmtimeve të shkaktuara gjatë realizimit të punimeve për rrjetin e kanalizimit. Rruga aktualisht është në gjendje të dëmtuar, duke vështirësuar qarkullimin dhe duke ndikuar negativisht në jetën e përditshme të banorëve.

12,519.36 €

Kulturë, Rini, Sport me kod, 850, nën-programi Shërbimet Kulturore – Istog me kod 85017

Projekti i ri (Blerja e Tabelës Sportive)

Arsyetim: Instalimi i këtyre pajisjeve është një hap i rëndësishëm për përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe përmbushjen e kërkesave moderne për zhvillimin e sporteve në nivel lokal.

10,000.00 €

Në kuadër të programit Arsim dhe Shkencë me kod, 911 nën-programi Arsimi parashkollor- Istog me kod 92530,

(52798) (Ndërtimi i këndit të lojërave në përparafillor në 5 Qerdhet e komunës së Istogut).

Arsyetim: Obligim kontraktual realizimi i këtij projekti është e nevojshme për të përmbushur obligimet kontraktuale dhe për të siguruar mjedise të përshtatshme për fëmijët.

1.202.00 €

Në kuadër të programit Arsim dhe Shkencë me kod, 912 nën-programi Arsim fillor, I mesëm i ulet me kod 93480,

(54740) (Renovimi i Kulmit, Klasave dhe Nyejve Sanitare në SH.F Martin Camaj-Serbobran).

Arsyetim: Renovimi i kulmit, klasave dhe nevojave sanitare në SH.F. Martin Camaj - Serbobran është një obligim kontraktual nga viti i kaluar, për të siguruar kushte më të mira për mësimdhënie dhe shërbime për nxënësit dhe stafin mësimor.

7,133.12 €

Në kuadër të programit Arsim dhe Shkencë me kod, 922 nën-programi Arsim i mesëm i lartë me kod 94680,

(55190) (Fasadimi i objektit të shkollës Mithat Frashëri në Gurakoc).

Arsyetim: Fasadimi i objektit të shkollës "Mithat Frashëri" në Gurakoc është një obligim kontraktual për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës shkollore. Ky projekt ka për qëllim përmirësimin e pamjes estetike të objektit dhe sigurimin e kushteve më të mira për mësimdhënie dhe ambient të shëndetshëm për nxënësit dhe stafin.

4,930.00 €

(52789) (Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në SH.F. Bajram Curri).

Arsyetim: Obligim kontraktual, projekt është i domosdoshëm për përmbushjen e kushteve infrastrukturore të kërkuara dhe për të siguruar një mjedis më të sigurt dhe funksional për arsimimin e nxënësve.

9,050.00 €

II. Fondi burimor 21, shuma prej 734,656.74 € të bartet si në vijim:

1. Subvencione dhe Transfere:

15,000.00 €

Infrastruktura Rrugore (18017):

Arsyetim: Subvencionimi për riaktivizimin e ndërmarrjes NPL "Stacioni i Autobusëve" Sha Istog, në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e infrastrukturës së transportit në komunën e Istogut, riaktivizimi i ndërmarrjes NPL "Stacioni i Autobusëve" është një hap i domosdoshëm. Ky projekt synon të përmirësojë funksionimin e stacionit të autobusëve, të optimizojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe të krijojë mundësi për zhvillim ekonomik në këtë sektor.

15,000.00 €

2. Investimet Kapitale:

719,656.74 €

Buxhet dhe Financa me kod 175, nën-programi Buxheti – Istog me kod 17517, projektet:

(50240) (Projekti me participim te Komunitetetit ,ministrive te linjës,Donatoret e jashtëm).

Arsyetim: Bazuar në nevojën urgjente për intervenime emergjente në objektin e Palestrës së Sportit në Komunën e Istogut, dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është i domosdoshëm bartja e mjeteve buxhetore për realizimin e këtij aktiviteti.

116,000.00 €

Projekti i ri (Ndërtimi i shtëpisë së komunitetit në "Shushicë të Ulët").

Arsyetim: Projekt i ri, në fshatin Shushicë e Ulët mungon një hapësirë funksionale për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe komunitare, çka paraqet një pengesë për përfshirjen aktive të qytetarëve, veçanërisht të rinjve, në jetën kulturore dhe sociale të vendbanimit

8,900.00 €

Projekti i ri (Ndërtimi i shtëpisë së komunitetit dhe infrastruktures se jashtme në "Orroberdë").

Arsyetim: Projekt i ri, Fshati Orroberdë nuk posedon hapësira të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe komunitare, gjë që ka ndikuar negativisht në përfshirjen e banorëve në jetën shoqërore dhe kulturor

20,000.00 €

Projekti i ri (Ndërtimi i rrugës Kërrninë e Ulët-Volljat-Shpronësimet).

Arsyetim: Pagesa e shpronësimeve për rrugën Kërrninë e ulët-Volljakë, Me qëllim të realizimit të projektit infrastrukturor për ndërtimin e rrugës Kërrninë e Ulët – Volljakë, është e domosdoshme finalizimi i procedurave të shpronësimit të pronave që preken nga traseja e rrugës.

28,195.50 €

Projekti i ri (Ndërtimi i shtëpisë së komunitetit në "Rakosh").

Arsyetim: Projekt i ri, Fshati Rakosh përballet me mungesë të hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe komunitare, çka pengon përfshirjen aktive të banorëve në jetën sociale dhe kulturore. Për këtë arsye, propozohet bartja e mjeteve buxhetore për fillimin e një projekti të ri që do të mundësojë krijimin e kushteve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe forcimin e lidhjeve brenda komunitetit.

20,000.00 €

Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia me kod, 180 nën-programi Infrastruktura Rrugore – Istog me kod 18017,

(53382) (Ndërtimi i trotuarit në Bajicë, Kashic dhe Saradran).

Arsyetim: Projekti për ndërtimin e trotuarit në Bajicë, Kashic dhe Saradran është në kuadër të obligimeve kontraktuale të vitit 2024. Për të siguruar përfundimin e punimeve në afatin e parashikuar dhe për të respektuar angazhimet e marrëveshjes, kërkohet bartja e mjeteve buxhetore për realizimin e këtij projekti në linjën përkatëse.

53,858.34€

Projekti i ri (Ndërtimi i kanalizimit në Shushicë të poshtme faza 2).

Arsyetim: Projekti për ndërtimin e kanalizimit në Shushicë të Ulët, faza 2, e cila lidhet me realizimin e fazës së parë në vitin 2024, është i domosdoshëm për të përfunduar infrastrukturën e kanalizimit në këtë zonë.

10,000.00 €

Zhvillim Ekonomik me kod 470, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik– Istog me kod 48017,

(54925) (Ndërtimi i rrugëve në Vrellë lagja "Demaj, Blakaj, Dreshaj, Bicaj" dhe "Belaj")

Arsyetim: Projekti për ndërtimin e rrugëve në Vrellë, përfshirë lagjet "Demaj, Blakaj, Dreshaj, Bicaj" dhe "Belaj", ka hasur në vonesa për shkak të ankesa të procedurave dhe procesit të kontraktimit. Pasi kontrata është nënshkruar, për të mundësuar përmbushjen e obligimeve të mbetura dhe për të siguruar përfundimin e punimeve sipas planit, kërkohet shtimi i buxhetit për këtë aktivitet, duke mundësuar përfshirjen e shpenzimeve të nevojshme për realizimin e plotë të projektit.

30,000.00 €

(55804) (Ndërtimi i rrugës "Agimi i Lirisë" në Kaliqan dhe Lagja Osmanaj dhe Hakaj).

Arsyetim: Projekti për ndërtimin e rrugës "Agimi i Lirisë" në Kaliqan dhe lagjet Osmanaj e Hakaj ka qenë i pezulluar për shkak të ankesave në procedurat e prokurimit. Pas përfundimit të procedurave ligjore dhe nënshkrimit të kontratës, është e nevojshme shtimi i buxhetit për të mundësuar përmbushjen e obligimeve kontraktuale dhe realizimin e plotë të projektit në përputhje me kushtet e kontratës dhe dinamikën e paraparë të punimeve.

21,708.00 €

(54943) (Ndërtimi i rrugëve në Zabllaq lagjaet " Dervishaj, Mehmetaj dhe Ahmetaj").

Arsyetim: Projekti për ndërtimin e rrugëve në Zabllaq, përfshirë lagjet "Dervishaj, Mehmetaj dhe Ahmetaj", ka pasur vonesa për shkak të ankesa në procedurat e prokurimit. Pasi kontrata është nënshkruar, kërkohet shtimi i buxhetit për të mundësuar përmbushjen e obligimeve të mbetura dhe për të siguruar përfundimin e punimeve në përputhje me kontratën.

89,338.90 €

Ky shtim do të sigurojë realizimin e plotë të projektit dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore në këtë zonë.

(54923) (Ndërtimi i rrugëve ne Gurrakoc lagja "Gegaj".lagja "Kabashi").

Arsyetim: Projekti për ndërtimin e rrugëve në lagjet "Gegaj" dhe "Kabashi" të Gurrakocit ka pësuar vonesa për shkak të ankesave gjatë fazës së prokurimit. Pas përmbylljes së procedurave dhe nënshkrimit të kontratës, kërkohet shtimi i buxhetit për të mundësuar fshirjen e obligimeve të mbetura dhe realizimin e plotë të projektit, në përputhje me kushtet kontraktuale dhe planifikimin e investimeve kapitale për vitin aktual.

37,706.00 €

Projekti i ri (Ndërtimi i rrugëve në lagjen Januzaj në Lubozhdë)

Arsyetim: Ndërtimi i rrugës në lagjen Pacaj, Prekallë, është një kërkesë e vazhdueshme e banorëve të fshatit, e cila ka për qëllim përmirësimin e kushteve të qarkullimit dhe jetesës. Ky projekt është i domosdoshëm për zhvillimin e infrastrukturës rrugore, duke siguruar lidhje më të mira me pjesët tjera të komunës dhe përmirësimin e aksesit për banorët.

15,000.00 €

Projekti i ri (Ndërtimi i rrugës në lagjen Pacaj në Prekallë).

Arsyetim: Ndërtimi i rrugës në fshatin Mojstir është i nevojshëm si pasojë e dëmtimeve të shkaktuara gjatë realizimit të punimeve për rrjetin e kanalizimit. Rruga aktualisht është në gjendje të dëmtuar, duke vështirësuar qarkullimin dhe duke ndikuar negativisht në jetën e përditshme të banorëve. Realizimi i këtij projekti do të rikthejë funksionalitetin e infrastrukturës rrugore dhe do të përmbyllë në mënyrë të plotë investimin në zonë.

15,000.00 €

Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale me kod, 730 nën-programi Shërbimet e shëndetësisë primare – Istog me kod 74000,

(55750) (Blerja e automjetit në QKMF - Për vizita shtëpiake).

Arsyetim: Projekti ka qenë i planifikuar në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2025, po i njëjti është marrë nga vendimet përmbartimore përshkak të kontratës kolektive, dhe është shumë urgjente blerja e një veture për nevojat e QKMF-së

24,000.00 €

Kulturë, Rini, Sport me kod, 850, nën-programi Shërbimet Kulturore - Istog me kod 85017

Projekti i ri (Renovimi i hapësirave të brendshme të Palestrës së Sporteve në Istog).

200,000.00€

Arsyetim: Palestra e Sporteve në Istog ka rëndësi të veçantë për

zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe shëndetësore në nivel lokal dhe rajonal. Për të mundësuar funksionalizimin e plotë dhe përfundimtar të saj, është e domosdoshme bartja e mjeteve buxhetore, duke siguruar përfundimin e punimeve të mbetura. Ky projekt emergjent ka një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve për sportistët dhe rininë, si dhe në mbështetje të zhvillimit të aktiviteteve kulturore dhe sportive në komunë.

Projekti i ri (Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në Palestrën e Sporteve në Vrellë)

Arsyetim: Për të mundësuar funksionimin e plotë dhe të sigurt të Palestrës së Sporteve në Vrellë, është e nevojshme finalizimi i infrastrukturës së jashtme të saj. Ky projekt është i rëndësishëm për përmirësimin e kushteve të aksesit dhe sigurisë për përdoruesit e objektit, duke siguruar hapësira adekuate për parkim, rrugë qarkullimi dhe paisje të tjera infrastrukturore.

25,000.00 €

Në kuadër të programit Arsim dhe Shkencë me kod, 922 nën-programi Arsim i mesëm i lartë me kod 94680,

(52789) (Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në SH.F. Bajram Curri).

Arsyetim: Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në SH.F. Bajram Curri është një obligim kontraktual, i cili ka për qëllim përmirësimin e kushteve të qarkullimit dhe sigurisë për nxënësit dhe stafin, si dhe rregullimin e hapësirave për aktivitetet shkollore. Ky projekt është i domosdoshëm për përmbushjen e kushteve infrastrukturore të kërkuara dhe për të siguruar një mjedis më të sigurt dhe funksional për arsimimin e nxënësve.

4,950.00 €

Vërejtje:

Aneks i këtij vendimi është edhe tablea e arsyetimeve.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesën: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe autorizohet Drejtori për Buxhet dhe Financa për përshtatjen e zërave në Tabelën e arsyetimeve sipas nevojës financiare.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Ministra e Financave, Punës dhe Transferit, Kryetari i Komunës, Drejtori për Buxhet e Financa, Zyrtari kryesor Financiar (ZKF) dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit të Komunës së Istogut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.76 /2025	Data: 30.04.2025	

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c) nenit 68 paragrafi 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008) dhe në pajtim me nenin 34 paragrafi 34.2 të Statutit të Komunës, 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2025 shqyrtoi dhe shpalli në diskutim publik Rregulloren për Subvencione dhe mori këtë:

V E N D I M SHPALLJE NË DISKUTIM PUBLIK

1. MIRATOHET Vendimi për shpallje në diskutim publik të Draft- Rregullores për Subvencione.
2. Diskutimi publik për Draft-Rregulloren e cekur më lartë, do të jetë i hapur prej 30.04.2025 deri më 15.05.2025.
3. Inkurajohen dhe ftohen të gjithë qytetarët, personat juridik dhe shoqatat civile në territorin e Komunës së Istogut, që t'i parashtrojnë vërejtjet dhe propozimet e tyre në këtë Rregullore brenda kohës dhe afatit të përcaktuar në pikën 2. të këtij Vendimi.
4. Për çdo informatë të interesuarit mund të drejtohen në Zyrën për Informim, zyrtarit përgjegjës për Dëgjime Publike, në objektin e Komunës së Istogut.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij në Kuvendin e Komunës së Istogut. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Zyrtari përgjegjës për Dëgjime Publike dhe Kryetari i Komunës.
6. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetari i komunës dhe një kopje në arkivin e Kuvendit të Komunës së Istogut.



Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

(Signature of Enver Rugova)



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.77 /2025	Data: 30.04.2025	

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c) nenit 68 paragrafi 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008) dhe në pajtim me nenin 34 paragrafi 34.2 të Statutit të Komunës, 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2025 shqyrtoi dhe shpalli në diskutim publik Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale, dhe mori këtë:

V E N D I M SHPLLJE NË DISKUTIM PUBLIK

1. MIRATOHET Vendimi për shpallje në diskutim publik të Draft- Rregullores për Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale.
2. Diskutimi publik për Draft-Rregulloren e cekur më lartë, do të jetë i hapur prej 30.04.2025 deri më 15.05.2025.
3. Inkurajohen dhe ftohen të gjithë qytetarët, personat juridik dhe shoqatat civile në territorin e Komunës së Istogut, që t'i parashtrojnë vërejtjet dhe propozimet e tyre në këtë Rregullore brenda kohës dhe afatit të përcaktuar në pikën 2. të këtij Vendimi.
4. Për çdo informatë të interesuarit mund të drejtohen në Zyrën për Informim, zyrtarit përgjegjës për Dëgjime Publike, në objektin e Komunës së Istogut.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij në Kuvendin e Komunës së Istogut. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Zyrtari përgjegjës për Dëgjime Publike dhe Drejtoria për Administratë.
6. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetari i komunës dhe një kopje në arkivin e Kuvendit të Komunës së Istogut.

00 Nr./Br. 033-50 Nr. i faq./Br. str. 01

Data/Datum 07 / 05 / 2025

ISTOG - ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

E Rugova

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.78 /2025	Data: 30.04.2025	

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c) nenit 68 paragrafi 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008) dhe në pajtim me nenin 34 paragrafi 34.2 të Statutit të Komunës, 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2025 shqyrtoi dhe shpalli në diskutim publik Rregulloren për Tregun tërë ditë në Istog dhe mori këtë:

V E N D I M SHPALLJE NË DISKUTIM PUBLIK

1. MIRATOHET Vendimi për shpallje në diskutim publik të Draft- Rregullores për Tregun tërë ditë në Istog.
2. Diskutimi publik për Draft-Rregulloren e cekur më lartë, do të jetë i hapur prej 30.04.2025 deri më 15.05.2025.
3. Inkurajohen dhe ftohen të gjithë qytetarët, personat juridik dhe shoqatat civile në territorin e Komunës së Istogut, që t'i parashtrorjnë vërejtjet dhe propozimet e tyre në këtë Rregullore brenda kohës dhe afatit të përcaktuar në pikën 2. të këtij Vendimi.
4. Për çdo informatë të interesuarit mund të drejtohen në Zyrën për Informim, zyrtarit përgjegjës për Dëgjime Publike, në objektin e Komunës së Istogut.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij në Kuvendin e Komunës së Istogut. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Zyrtari përgjegjës për Dëgjime Publike dhe Drejtoria për Inspeksion.
6. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetari i komunës dhe një kopje në arkivin e Kuvendit të Komunës së Istogut.

	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO КОСОВСКА РЕПУБЛИКА - РЕПУБЛИКА КОСОВО ДРЕЈТОРИЈА ПЕР АДМИНИСТРАТЕ - ДИРЕКЦИЈА ОПРЕВЛ	
II	
Nr./Br. <u>033-53</u> Nr. i faq./Br. str. <u>01</u>	
Data/Datum <u>07 / 05 / 2025</u>	
ISTOG - ISTOK	

Kryesuesi i Kuvendit

z. Enver Rugova

ERUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00.Nr.80/2025	Data: 30.04.2025	

Kuvendi Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) e në lidhje me nenin 24 dhe 25, paragrafi 4 dhe 5 lidhur me paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019) ,neni 29 paragrafi 1,2 dhe 4 neni 31,i Rregullores (QRK) Nr.09/2020,Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010,si dhe raportit të Vlerësimit nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme me nr. të referencës Nr.66/2025 i datës 23.04.2025 në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2025 të mori këtë:

VENDIM
PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUJTSHME TË KOMUNËS SË ISTOGUT ME
PRONËN E PALUAJTSHME TË PERSONIT FIZIK z. Ardi Maraj

- 1.Miratohet- Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës se Istogut me pronën e paluajtshme në pronësi private e evidentuar në emër z. Ardi Maraj nga fshati Vrellë K, Istogu më qellim të realizimit të interesit të përgjithshëm publik, për sigurimin hapësirës për varreza të fshatit Vrellë K, Istog me kërkesë të komunitetit.
- 2.Bazuar sipas pikës 1 të këtij vendimi njësia kadastrale me nr.P-70806008-00249-0 zona kadastrale në Vrellë K, Istog me sipërfaqe të përgjithshme prej (3256)m² e evidentuar sipas certifikatës pronësore pronë private në emër të z.Ardi Maraj do të këmbëhet me sipërfaqen e pronës komunale prej (1133)m² sipërfaqe e përgjithshme e parcelës e evidentuar sipas njësisë kadastrale me nr.P-70806020-00030-35 zona në Istog.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës. Për realizimin e tij kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, si dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës se Istogut.
- 4.Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen më kontratë e cila do të lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të pronës së paluajtshme e cila do të këmbëhet.
- 5.Më nga një kopje të këtij vendimi të njoftohen: Kryetari i Komunës ,Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, si dhe një kopje të mbetet në arkivin e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

Enver Rugova

11

00 Nr./Br. 039-61 Nr. i faq/Br.str 01

Data/Datum 07/05/2025

ISTOG • ISTOK

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00.Nr.81 /2025	Data: 30.04.2025	

Kuvendi Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) e në lidhje me nenin 24 dhe 25, paragrafi 4 dhe 5 lidhur me paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019) ,neni 29 paragrafi 1,2 dhe 4 neni 31,i Rregullores (QRK) Nr.09/2020,Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010,si dhe raportit të Vlerësimit nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme me nr. të referencës 65-2/2025 i datës 23.04.2025 në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2025 të mori këtë:

VENDIM
PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUJTSHME TË KOMUNËS SË ISTOGUT ME
PRONEN E PALUJTSHME TË PERSONIT FIZIK z. Avdullah Bytyçi

- 1.Miratohet -Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës se Istogut me pronën e paluajtshme në pronësi private e evidentuar në emër z. Avdullah Bytyçi nga Istogu më qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm publik, për sigurimin sipërfaqes për rregullimin e shtratit mbrojtës të lumit "Bullovan" në Istog.
- 2.Bazuar sipas pikës 1 të këtij vendimi njësia kadastrale me nr.P-70806020-00601-15 zona kadastrale në Istog me sipërfaqe të përgjithshme prej (467)m² e evidentuar sipas certifikatës pronësore pronë private në emër të z.Avdullah Bytyçi do të këmbëhet me sipërfaqen e pronës komunale prej (700)m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej (2565)m² e evidentuar sipas njësisë kadastrale me nr.P-70806020-00165-0 zona kadastrale në Istog.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës. Për realizimin e tij kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, si dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis.
- 4.Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen më kontratë e cila do të lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të pronës së paluajtshme e cila do të këmbëhet.
5. Më nga një kopje të këtij vendimi të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.

00

REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
DREJTORIA PËR KADASTËR PRONË DHE GJEODEZI

Nr./Br. 033-62 Nr. i faq/Br.str 01

Data/Datum 07 / 05 / 2025

ISTOG • ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

E. Rugova

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00.Nr.82 /2025	Data: 30.04.2025	

Kuvendi Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) e në lidhje me nenin 24 dhe 25, paragrafi 4 dhe 5 lidhur me paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019) ,neni 29 paragrafi 1,2 dhe 4 neni 31,i Rregullores (QRK) Nr.09/2020,Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010,si dhe raportit të Vlerësimit nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme me nr. të referencës Nr.65/2025 i datës 23.04.2025 në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2025 të mori këtë:

VENDIM
PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË ISTOGUT ME
PRONEN E PALUAJTSHME TË PERSONIT FIZIK z. Brahim Sejda

- 1.Miratohet- vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës se Istogut me pronën e paluajtshme në pronësi private e evidentuar në emër z. Brahim Sejda nga fshati Kaliqan K,Istog më qellim të realizimit të interesit të përgjithshëm publik, për sigurimin hapësirës për varreza të fshatit Kaliqan K, Istog me kërkesë të komunitetit të fshatit.
- 2.Bazuar sipas pikës 1 të këtij vendimi njësia kadastrale me nr.P-70806022-00443-2 zona kadastrale në Kaliqan K,Istog me sipërfaqe të përgjithshme prej (1600)m² e evidentuar sipas certifikatës pronësore pronë private në emër të z.Brahim Sejda do të këmbëhet me sipërfaqen e pronës komunale prej (1600)m² nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës prej (4434) e evidentuar sipas njësisë kadastrale me nr.P-70806022-00436-0 zona kadastrale në Kaliqan.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe për realizimin e tij kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, si dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës se Istogut.
- 4.Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen më kontratë e cila do të lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të pronës së paluajtshme e cila do të këmbëhet.
- 5.Më nga një kopje të këtij vendimi të njoftohen: Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, si dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit

00

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK
DREJTORIA PËR KADASTËR PRONË DREJTORIA PËR KADASTËR PRONË

11

Nr./Br. 039-63 Nr. i faq./Br. 01

Data/Datum 07.05.2025

ISTOG • ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

E. Rugova



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00.Nr.83 /2025	Data: 30.04.2025	

Kuvendi Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) e në lidhje me nenin 24 dhe 25, paragrafi 4 dhe 5 lidhur me paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019) ,neni 29 paragrafi 1,2 dhe 4 neni 31,i Rregullores (QRK) Nr.09/2020,Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010,si dhe raportit të Vlerësimit nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme me nr. të referencës 65-3/2025 i datës 23.04.2025 në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2025 të mori këtë:

VENDIM

PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUJTSHME TË KOMUNËS SË ISTOGUT ME PRONEN E PALUAJTSHME TË PERSONAVE FIZIK z. Avdullah Bytyçi 1/4, Ibrahim Bytyçi 1/4, Haxhi Bytyçi 1/4, Shkumbin Bytyçi 1/4

1.Miratohet- Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës se Istogut me pronën e paluajtshme në pronësi private e evidentuar në emër z. Avdullah Bytyçi 1/4, Ibrahim Bytyçi 1/4, Haxhi Bytyçi 1/4, Shkumbin Bytyçi 1/4 nga Istogu më qellim të realizimit të interesit të përgjithshëm publik, për sigurimin sipërfaqes për rregullimin e shtratit mbrojtës të lumit “Bullovani” në Istog.

2.Bazuar sipas pikës 1 të këtij vendimi njësia kadastrale me nr.P-70806020-00601-2 zona kadastrale në Istog me sipërfaqe të përgjithshme prej (400)m² e evidentuar sipas certifikatës pronësore pronë private në emër të z. Avdullah Bytyçi 1/4, Ibrahim Bytyçi 1/4, Haxhi Bytyçi 1/4, Shkumbin Bytyçi 1/4 do të këmbëhet me sipërfaqen e pronës komunale prej (600)m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej (2565)m² e evidentuar sipas njësisë kadastrale me nr.P-70806020-00165-0 zona kadastrale në Istog.

3.Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës. Për realizimin e tij kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, si dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës se Istogut.

4.Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen më kontratë e cila do të lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të pronës së paluajtshme e cila do të këmbëhet.

5. Më nga një kopje të këtij vendimi të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.

11

00 Nr./Br. 033-69 Nr. i faq/Br.str. 01

Data, Datum 07 / 05 / 2025

ISTOG • ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

ERUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.84/2025	Data: 30.04.2025	

Skupština opštine Istok, u skladu sa članom 12. stav 12.2 tačka d), članom 40. stav 40.2 tačka a) Zakona o lokalnoj samoupravi („Službeni list Republike Kosovo“ br. 28/2008) i članom 33.1. tačka 1) Statuta Opštine, 01 br. 62/10, na sjednici održanoj 30.04.2025. godine, usvojila je sljedeće:

ODLUKA O PONIŠTENJU OPŠTINSKE UREDBE BR. 187/2022 O KATEGORIZACIJI SPORTSKIH KLUBOVA

1. USVAJA se – Odluka o stavljanju van snage Opštinske uredbe br. 187/2022 od 29.12.2022. o kategorizaciji sportskih klubova,
2. Ova Odluka stupa na snagu 15 dana nakon registracije u protokolarnoj kancelariji MALU i 7 dana nakon objavljivanja na web stranici Opštine, a za njeno sprovođenje odgovoran je Gradonačelnik Opštine.
3. Kopija ove odluke dostavlja se: gradonačelniku, Ministarstvu za lokalnu upravu, Pravnoj kancelariji, a jedna kopija se dostavlja arhivi Skupštine.

Predsjedavajući Skupštine
g. Enver Rugova

E. Rugova



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
 RYKOTBOWE E KOSOWE - REPUBLIK KOSOWE
 DIREKTORATI PER ADMINISTRATE - DIREKTION UPRAVE



II

Nr./Br. 039-65
Nr. i faq/Br. str. 01

Data/Datum 07.05.2025

ISTOG • ISTOK